




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ëëë.kk.rks-gov.net; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e jashtëzakonshme, më datë 23.7.2013 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të ndërtimit të objektit të Shkollës Filllore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan,
3. Propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrës kadastrale nr.70403013-000162-2 te vendi i quajtur "Porodin" ZK-Gjilan.

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së nëntë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit,
Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile Shaban Terziu
Përfaqësuesi i KVRL-së

Seancën e jashtëzakonshme të KK-së e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit duke iu kërkuar falje anëtarëve të Kuvendit sepse tash është koha e pushimeve, por për shkak se është paraqitur nevoja për të debatuar për dy pika urgjente e kemi ftuar këtë seancë. Kjo është seancë e jashtëzakonshme dhe ky është rendi i punës, nuk ka mundësi të propozojmë pika të tjera të rendit të punës.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,

Në punimet e seancës së jashtëzakonshme ishin 36 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan 5 : Sadudin Berisha, Abdyl Aliu, Rashit Sahiti, Mimoza Shkodran- Bislimi, Sabedin Kadriu

Sokol Haziri- unë iu përshëndes të gjithëve dhe para se të fillojmë me rendin e punës, por nuk e mora fjalën për rendin e punës, sepse ai në këtë seancë është i pandryshueshëm, por e mora fjalën për ta dhënë një vërejtje për TV “Valin” i cili i përcjell punimet e Kuvendit. Mirëpo raportimi i këtij mediumi nga seanca e fundit të KK, gjithqysh mund të quhej ndryshe, por jo raportim profesional dhe i pavarur.

Ne nuk kërkojmë që të na bëjnë neve reklamë, asndonjë partie politike veç e veç, por duhet të përcillen me dinjitet punimet e Kuvendit dhe vendimet që merren këtu të jenë të transmetuara ashtu si merren në KK. Nga lajmet që janë dëgjuar në ora 20 të mbrëmjes ka qenë një informim që definitivisht e deformon punën e këtij Kuvendi!

Pasqyron daljen e LDK-së jashtë, pasqyron atë çka ndodh jashtë Kuvendit dhe nuk i paraqet ato të cilat kanë qenë vendime të cilat me propozim të shumicës janë nxjerr në këtë Kuvend. Unë kërkoj që informimi të jetë objektiv dhe asgjë më tepër dhe as më pak, përpos të jetë objektiv dhe jo të pasqyrohen ato të cilat nuk janë veprime politike profesionale. Të pasqyrohen edhe ato, por të pasqyrohet e vërteta, sepse aty thuhet se me insistimin e LDK-së është bërë kjo gjë dhe as që thuhet se është heq nga rendi i punës. Për këtë arsyeje ne kërkojmë që në emër të grupit politik të AAK-së që informacionet të pasqyrohen ashtu siç janë.

Izmi Zeka- vërejtja e z. Sokolit vërtetë është e arsyeshme nëse ka ndodhur kështu, sepse mediet edhe të shkruara, por edhe ato elektronike duhet t i paraqesin ngjarjet objektivisht dhe nuk është e lejuar që ta dezinformojnë publikun.

Arben Mehmeti- unë së pari kam vërejtje në rendin e punës, sepse ky rend i punës nuk ka të bëjë asgjë me ndonjë punë të jashtëzakonshme dhe kjo për mua është një befasi që Kuvendi thirret në këso seanca pa asnjë arsyeje. Deri më sot ne nuk e kemi asnjë informacion se kemi ndonjë punë e cila është e ngutshme për një seancë të tillë.

Nuk duhet kryesuesi ta ngarkojë Kuvendin me çështje të cilat mund të presin dhe të cilat duhet të kalojnë nëpër procedura të duhura. Duhet dhënë sqarim se cila është arsyeja e asaj që e keni ftuar këtë seancë në këtë mënyrë?

Qemajl Mustafa- të dy çështjet janë emergjente, por Sali Fazliu është zyrtar i pronës i cili fillon për ta elaboruar dhe do t’ i jep arsyet pse është thirr kjo seancë dhe pse është ashtu? Komisioni Evropian i ka dhënë afat 30 për kompletim të procedurës dhe për të filluar procesi i vlerësimit të pronës për shpronësim.

Tash vlerësuesi ka kërkuar që në kuadër të MEF-it ka kërkuar një vendim të Kuvendit për këmbim të pronës tokë me tokë edhe pse ne e kemi marrë vendimin për shpronësim.

Kjo neve si Komunë na konvenon, sepse inkasimi është bukur i ulët dhe keshi mungon, por tokë edhe pak kemi. Ne e kemi propozuar një vend të cilin do ta shihni dhe mendoj se është shumë e arsyeshme të shkojmë me këtë propozim.

Kjo është me emergjencë, por edhe rasti i dytë për shkak të mundësisë së ndërtimit të shtëpive për ato dy familje gjatë sezonit të verës.

Shumë e falënderoj Sokolin për atë reagim, nëse vërtetë kështu ka qenë, por ky reagim ka qenë desh të vijë në zyrën time nga Zyra e Informimit të Komunës, por për fat të keq nuk ka ardhur!

Selim Selimi- këto ditë është botuar një libër i cili quhet "Anamorava" autore e së cilës është Syzana Mushkolaj në të cilin libër përshkruhet trashëgimia kulturore, bukuritë natyrore, por edhe viset turistike. Kjo është një pjesë e këtij libri për të cilin duhet dhënë lëvdata Komunës për financim të këtij libri. Mirëpo do të shprehi edhe një shqetësim, sepse kur ta shfletojmë librin do të shohim se më tepër dominon ajo fryma katolike ortodokse se sa myslimane. Për këtë dëshmojnë fotografitë, unë nuk jam për ta nënçmuar askënd dhe sikur të ishte një barazim, por këtu janë 11 pamje nga kishat katolike, 7 pamje nga kishat ortodokse, kurse vetëm 5 pamje nga xhamitë. Ajo më e rënda është se Komuna e Vitisë nga trashëgimia kulturore përfaqësohet vetëm me kisha katolike. Për mua ky është një diskriminim për komunitetin shqiptar i cili gjendet këtu. Kjo është një pakënaqësi e imja.

Izmi Zeka- për neve kjo është art është kulturë, pavarësisht e shumicës apo pakicës dhe ne e respektojmë secilin besim dhe e kemi për obligim që ta hedhim në letër atë çka mundemi dhe për punë të mira duhet respektuar secilin. Kjo është kulturë e jona si ajo myslimane, katolike dhe ortodokse.

Qemajl Mustafa- së pari po theksoj se nuk ka qenë qëllim për ta mat sa fotografi janë të xhamive, sa janë të kishave, ortodokse apo katolike, mandej sa prej trashëgimisë kulturore në Viti, Dardanë dhe Gjilan. Më erdhi ideja për ta bërë një krahasim se a është prezantuar më shumë Dardana, Vitia apo Gjilani, sepse ne e kemi financuar. Nëse shkojmë kështu atëherë duhet t' i qesim në peshojë shumë gjëra. Ky ka qenë një vendim i imi, unë e marrë përgjegjësinë për këtë, për ta botuar një libër të asaj natyre, një libër të këndshëm, prezantim të kësaj ane me fotografi të asaj trashëgimie kulturore natyrore historike dhe pak ka momente turistike, pa pretendimin që çdo gjë është në rregull. Prej sot filloi debati dhe librin do ta keni në dorë të gjithë, sepse 500 libra dhurohen, 500 të tjera shkojnë në rrjetin shitës. Atëherë kur ta hapni librin do të shihni se çka ka në te dhe atëherë do të fillojë debati për te. Qëllim është botimi i ardhshëm të jetë më i rregullt më i mirë.

2. Propozim vendimi për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat të ndërtimit të objektit të Shkollës Fillore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan,

Izmi Zeka- për të dhënë sqarime lidhur me këtë pikë, fjalën do ta ketë zyrtari për pronë, z. Sali Fazliu i cili është më kompetent për këtë çështje.

Sali Fazliu- KK i Gjilanit në seancën e mbajtur më 23 prill 2013 ka marrë vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e sipërfaqes tokësore prej 69 ari e 23 m, nga ngastra kadastrale 45/1 dhe 46/3 në fshatin Shurdhan për nevojat e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në këtë fshat e cila shkollë do të financohet nga Komisioni Evropian. Vlera e këtij investimi është 668 mijë e 395 €. Duke u mbështetur në këtë dhe në Ligjin mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme kryetari i Komunës ka nxjerr vendimin për shpronësimin e kësaj sipërfaqe e cila është shpall zonë me interes të

veçantë për qëllimin e cekur më lartë. Komisioni Evropian ka kërkuar që tërë këtë procedurë ta kryejë deri më 10 gusht të këtij viti. Mirëpo pasi që procedura për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme marrin kohë, por edhe në anën tjetër edhe Komuna ballafaqohet me mungesë të mjeteve financiare për kompensim të këtyre pronave, kurse një pronë e cila shpronësohet mund të regjistrohet në emër të Komunës vetëm pasi të kryhet kompensimi, atëherë është paraqitur nevoja që të bëhet këmbimi i pronës së paluajtshme komunale me pronë private. Ne kemi bërë kërkesë që të bëhet vlerësimi i këtyre dy pronave, mirëpo MEF-i na është drejtuar me një kërkesë që Kuvendi së pari të merr një vendim paraprak me të cilin e lejon këtë këmbim, kurse pas kësaj procedure ata e bëjnë vlerësimin e këtyre paluajtshmërive.

Pas vlerësimit atëherë dihet se sa sipërfaqe komunale duhet t'epet për sipërfaqen e cila shpronësohet. Këmbimin e lejon edhe ligji për interes publik, prandaj shkolla është interes publik, kurse Komuna nuk ka pronë në atë zonë dhe për këtë arsyeje duhet ta bëjmë këtë këmbim. Lokacioni ku duhet të bëhet këmbimi është në fshatin Livoç i Epërm mbi Aeroport.

Arben Mehmeti- së pari nuk duhet të keqkuptohemi si grup më madh opozitar në këtë Kuvend, sepse ne nuk jemi kundër vendimeve për ndërtim të shkollave dhe institucioneve të ndryshme publike. Mirëpo për rastin për të cilin jemi duke diskutuar është një vendim i paligjshëm, është në kundërshtim me ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronave dhe për këmbim të tyre. Mua më vjen keq që Salihu, zyrtari për pronë po e propozon para këtij Kuvendi i cili e ka për obligim t' i respektojë procedurat ligjore dhe i ik deklarimit para Kuvendit për atë se a është i ligjshëm vendimi në këtë moment, apo nuk është? Me ligj lejohen të bëhen këto këmbime, por nuk e tha se janë disa afate ligjore që kufizojnë afate kohore për të marrë vendime.

Në seancën e parafundit ne e kemi pasur në diskutim çështjen e dhënies së pronës në shfrytëzim dhe atëherë ishte një dilemë e jona se a lejohet apo jo? Edhe në këtë rast ne mendojmë se ende nuk janë sqaruar mirë procedurat ligjore dhe nuk kemi përgjigje nga ministria përkatëse, nuk kemi marrë ndonjë opinion real lidhur me këtë. Në këtë çast që po e diskutojmë këtë për neve është diskutabil edhe lokacioni për të cilin bëhet ndërrimi dhe ne si KK dhe anëtarë të Kuvendit nuk kemi ndonjë material të saktë preciz se për cilat hapësira kërkohet ndërrimi?

Nga Prishtina gjegjësisht ministria përkatëse janë dhënë disa sqarime, por ne nuk e kemi këtë dokument për të parë se çka kanë kërkuar ata? Mendoj se për neve është me rëndësi që të kemi edhe më tutje informata të mjaftueshme lidhur me pronat me të cilat bëhet këmbimi. Është mirë edhe njëherë Zyra Ligjore të na e sqarojë këtë vendim dhe këtë procedurë se sa është i ligjshëm ky propozim-vendim?

Sali Fazliu- sa i përket këmbimit të pronës Komunale në aspektin ligjor, neni 11 i Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale e rregullon çështjen e këmbimit me personat fizik, por edhe me ata juridik. Në vijim zyrtari i pronës e lexon paragrafin e parë të këtij neni.

Sokol Haziri- ne si grupim politik parimisht e mbështesim këtë çështje dhe do të votojmë për, por përgjegjësia për të gjitha ato që i tha Arbeni i bie propozuesit. Mirëpo kur është çështje e investimeve nga jashtë për të cilat të gjithë flasim, unë mendoj se nuk ia vlen të shtyhem rreth ligjit dhe ligjshmërisë, sepse janë autoritet e

tjera që e vlerësojnë këtë punë dhe është para kësaj dobia materiale që e nxjerr Komuna nga një investim i huaj dhe falas. Unë mendoj se ia vlen shumë e shumë më shpejt për pa hezituat ta marrim një vendim të tillë duke e pasur parasysh interesin publik dhe duke e pasur parasysh interesin e zonës e që është zonë kufitare për të cilën po bisedojmë. Prandaj ne pa hezitim e përkrahim, por me një kërkesë që në të ardhmen të përcaktohet vlera e këmbimit të tokës dhe ta dimë qartë se bëhet fjalë për tokën që është në Gjilan dhe një pjesë që është në Shurdhan.

Arben Maliqi- edhe grupi i jonë në parim e mbështesim, sepse ky është interes vital dhe bëhet fjalë për arsim dhe për një shkollë e cila ka pasur nevojë moti dhe besoj se të gjithë do të jemi të pajtimit. Është thirr seancë e jashtëzakonshme, por ia vlen për ta mbajtur këtë seancë dhe ne jemi të pajtimit.

Xhyzide Ismaili- kjo kërkesë ka qenë në Komitetin e Pronës, është sqaruar shumë mirë nga zyrtari dhe të gjithë anëtarët e komiteti e kanë përkrah në mënyrë unanime.

Unë dhe të gjithë jemi për ndërtim të shkollave pa marrë parasysh se në cilin vend ndërtohen ato aq më tepër kur një shkollë e tillë është një dhuratë shumë e rëndësishme nga Komisioni Evropian, por të cilët edhe i kërkojnë edhe kushtet e duhura për ndërtim të shkollave dhe nuk e bëjnë ndonjë investim dosido.

Unë kërkoj që ky propozim-vendim të përkrahet unanimitet dhe shkolla të ndërtohet sa më parë.

Arben Mehmeti- ne në fillim e thamë se absolut nuk jemi kundër ndërtimit të shkollave, por jemi vetëm për respektim të ligjshmërisë. Në këtë rast nuk jemi për vendime të shpejta dhe në këtë rast ky vendim nuk ka qenë desh të jetë kaq i shpejtë për çështje të jashtëzakonshme. Është përgjegjësi e organeve komunale që të merren në mënyrë të zakonshme me interesat e qytetarëve dhe jo në këtë formë, sepse kjo nënkupton një lloj papërgjegjësie dhe jo serioziteti që janë në shtrirjen e çështjeve që janë në interes të qytetarëve të Gjilanit. Ne nuk kemi dokument nga Komisioni Evropian që deri më 10 gusht duhet të përfundojë procedura, por ne nuk e kemi këtë dokument dhe nëse është së paku ka qenë desh t'i respektoni edhe anëtarët e Kuvendit dhe t'ia dërgoni edhe atë rekomandim. Le të merret përgjegjësia nga Zyra Ligjore, nga Drejtoria e Kadastrit dhe nga kryesuesi që ta kurseni nga veprimet e paligjshme në këtë Kuvend, sepse jeni në një fazë të ndjeshme. Komisioni evropian nuk hyn në transaksione ku ka dilema ligjore dhe mund të humb një donacion shumë i rëndësishëm.

Në këtë rast ne si LDK e mbështesim për t'u ndërtuar shkolla dhe çdo lloj institucioni publik, por me sugjerimin që kujdes maksimal dhe respektim të ligjeve dhe mos i sillini gjëra të zakonshme si të jashtëzakonshme e të cilat janë interes i atyre qytetarëve.

Izmi Zeka- po kërkohet një ligjshmeri, por ne pikërisht për shkak të ligjshmërisë e kemi sjell këtu. Procedurat janë zbatuar në tërësi, nuk ka këtu paligjshmeri.

Qemajl Mustafa- Kuvendi ka marrë vendim dhe ekziston data kur është marrë ai vendim për shpronësim të asaj zone, shpronësim të pronarit për atë tokë. Mirëpo pasi që pronari ka këmbëngul që të merr tokë dhe jo para, ne e kemi dërguar kërkesën te vlerësuesi në Prishtinë që t'ia vlerësojë tokat. Vlerësuesi nuk ka desh ta bëjë një hap përpara, sepse është marrë vendimi për shpronësim, është nënkuptuar në fakt që është marrë vendim

për shpronësim me para. Për këtë arsyeje në Prishtinë iu është desh edhe një vendim i KK-së për këmbim të pronave të tokës me tokë. Edhe kjo është shpronësim, ai shpronësohet dhe pronësohet në vendin tjetër, por nuk është këmbim para me tokë, por është tokë me tokë. Ligjet e lejojnë një formë të tillë.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të këtij propozim-vendimi ?

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të ndërtimit të objektit të Shkollës Fillore “Bajram Curri “ në fshatin Shurdhan, me 34 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 ishin abstenime, kurse kundër nuk pati.

3. Propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrës kadastrale nr.70403013-000162-2 te vendi i quajtur “Porodin” ZK-Gjilan.

Sali Fazliu- KK në një seancë të vitit të kaluar ka marrë vendim që një pjesë e tokës komunale në vendin e quajtur në sipërfaqe prej 15 ari të dedikohet për banim të rasteve sociale në atë pjesë. Në bazë të atij vendimi janë ndarë katër troje, kurse një troll ka mbetur prej tetë ari në të cilin është menduar që të bëhet një ndërtesë për banim kolektiv. Kjo është inkorporuar edhe në Planin urbanistik i cili është miratuar në Kuvend. Deri më tash aty tri troje janë shfrytëzuar prej tri rasteve sociale dhe ka mbetur një troll me sipërfaqe prej dy ari dhe pjesa tjetër prej 7 ari.

Mirëpo në qytet i kemi dy raste të rënda (familje) me të cilat jemi duke u ballafaquar vite me radhë të cilat në njëfarë mënyre janë uzurpatorë të pronës komunale si është familja e Ismet Hotit i cili është i vendosur në pronën komunale vite me radhë në një pjesë të ngastrës kadastrale 3223 në rrugën “A. Presheva” prapa Xhamisë së Metresës dhe i cili e ka një ndërtim të egër dhe me atë pamje e ka shëmtuar atë pjesë dhe paraqet pengesë për pronarët e asaj pjese. Ajo pjesë është e paraparë për hapësirë gjelbëruese dhe si e tillë paraqet pengesë për realizmin e planit urbanistik.

Rasti i dytë është familja e Selim Ramadanit i cili është vendosur në pronën komunale te vendi i quajtur “Fidanishte” e cila sipërfaqe iu është dhënë Qendrës Sociokulturore “Don Bosko” në Gjilan dhe familja si e tillë paraqet pengesë për zhvillim normal të kësaj qendre. Për këtë arsyeje është e nevojshme që kjo familje të zhvendoset nga ky vend. Duke pasur parasysh se Komuna posedon me 7 ari tokë e cila është e dedikuar për këto raste, kërkojmë nga KK që ta merr vendimin për ndërrimin e destinimit të kësaj parcele që të bëhet parcelimi në tri troje të barabarta dhe në dy troje ku do të bëhet ky parcelim të vendosen këto dy familje.

Ejup Haziri- unë e kam një vërejtje te këto ndërtime, sepse në këtë rast përdoret termi uzurpator, sepse në aspektin edukativ ne japim një shembull të keq për qytetarët tanë. Realisht uzurpatorëve nuk duhet dhënë prona dhe krijuar mundësi të reja për të liruar atë hapësirë. Uzurpatorët nuk shpërblehen, ata dënohen!

Qemajl Mustafa- është bërë një tejkallim nga zyrtari (Salihu), sepse ata uzurpatorë janë kur të konstatojnë gjykata. Përndryshe nuk janë, sepse i kanë disa letra në bazë të të cilave ata janë vendos aty. Një që është te ish Kombinati ‘ Mlladost’, sepse ka qenë

punëtor i kësaj ndërmarrje iu ka dhënë një letër për banim të përkohshëm në hapësira të kombinatit, prandaj ai nuk mund të quhet uzurpator. Gjithashtu edhe tjetri e ka njëfarë letre të kryetarit të Komunës së atëhershme (ky që është vendosur te xhamia) dhe ata thirren në njëfarë të drejte të tyre për qëndrim të pakufizuar. Mirëpo si do që të jetë na po e marrim një vendim (janë familje tona) për t'iu dhënë përkohësisht mundësi për të banuar në dy ari tokë e cila tokë mbetet e Komunës, ndërtimet aty janë të Komunës dhe është statusi i njëjtë si të banimi social te objekti. Objekti mbetet i përhershëm i Komunës, kurse familjet që vendosen atje vendosen përkohësisht për derisa familjet nuk krijojnë një mirëqenie tjetër dhe të dislokohen prej atje dhe t'iu epet mundësi ndonjë familje tjetër. Kjo është e përkohshme dhe të gjitha këto familje sipas rregullave do të marrin një faturë mujore simbolike për qira (tri ose pesë euro).

Kjo qira shërben vetëm sa për t'iu përkujtuar se banesa nuk është pronë e tyre, por është e Komunës.

Arben Mehmeti- nga pika e rendit të punës dhe nga fjala e zyrtarit përkatës shihet se ne kemi të bëjmë me zgjidhje të disa rasteve të uzurpimeve. Në këtë rast po epet një hapësirë publike për t'iu vendosur uzurpatorët. Zyrtari përkatës tha se kemi të bëjmë me dy uzurpatorë të pronave publike dhe të cilëve po kërkojmë për t'iu bërë zgjidhje.

Ne si KK dhe si Qendër për Çështje Sociale nuk kemi ndonjë politikë realisht të matur në këtë drejtim, sepse rastet sociale janë të vendosura nëpër këto objekte përkohësisht, për derisa nuk ndryshon gjendja e tyre ekonomike. Mirëpo nuk e di asnjë rast që është bërë ndonjë vizitë në ato objekte dhe për të vërtetuar se mos ka ndonjë ndryshim të gjendjes dhe ka ndryshim të banorëve për ato objekte. Unë jam shumë i sigurt se kemi ndryshim radikal të gjendjes të atyre që banojnë në këto objekte kolektive sociale, mirëpo mungon angazhimi serioz i sektorëve përkatës për ta bërë ridefinimin e banuesve nëpër ato pjesë. Ne jemi dëshmitar se në këtë Kuvend jemi mashtruar disa herë duke menduar se jemi duke i bërë zgjidhje rasteve sociale, kurse në praktikë nëse shkojmë në vendin e ndodhjes shihet se kemi të bëjmë me ndërtime të mëdha e që nuk janë ndërtime sociale, por janë ndërtime dy kate e më lartë dhe nuk janë raste që kanë elemente të rasteve sociale! Kemi raste që ne i kemi ndarë lokacion dikujt që i ka dy të punësuar dhe ju e keni quajtur rast social pikërisht në lagjen "Porodinë".

Këto gjëra nuk duhet të ndodhin pa një analizë të mirë dhe të gjatë dhe të mirëfilltët, kurse sot është sa për t'iu ikë përgjegjësisë dhe për të thënë se e kemi diskutuar në mënyrë të zakonshme dhe vendimi ka qenë i jashtëzakonshëm. Mirëpo kjo nuk është ikje e përgjegjësisë, sepse në çastin që ndryshojnë qeverisjet duhet të dihet mirë se secili që nënshkruan diçka dhe ka nënshkruar diçka në mënyrë të kundërligjshme duhet të del para organeve të drejtësisë.

Sadri Arifi- do ta jap një sqarim se këto familje nuk janë raste sociale, por janë familje të cilat janë vendosur një kohë të gjatë në ato vende. Të rasti si Ismet Hoti dhe Selim Ramadani i kanë disa vendime me të cilat iu ka lejuar që të qëndrojnë aty.

Ismet Hotit gjykata ia ka njohur të drejtën e banimit të përhershëm, por Komuna përmes avokati e ka anuluar këtë vendim dhe e ka kthyer në rigjykim. Mirëpo ne nuk kemi kohë të presim aq gjatë derisa ai ta fiton betejën në gjyq. E tërë kjo është në funksion të lirimit të hapësirave publike, sepse aty po pengohet plani i zhvillimit urban.

Sokol Haziri- ne jemi parti e djathtë e drejtuar nga qendra dhe kur janë rastet e tilla kemi konsideratë të jashtëzakonshme dhe jo për këto dy familje, por për çdo skamnore të Kosovës. Parimisht ne i mbështesim të dy propozim-vendimet dhe do të votojmë për. Arsyeja e thjeshtë është interesi publik me atë që ndërlidhet me kërkesën sociale. Edhe kjo është çështje e Zyrës Ligjore, kurse ne marrim vendime politike dhe ne do të votojmë për dy rastet sipas propozim-vendimit.

E dyta unë kërkoj që të keni konsideratë dhe ju kryesues se KK punon me kapacitet të plotë deri në seancën e fundit të këtij mandati dhe ne duhet ta ruajmë autoritetin e këtij Kuvendi.

Arben Maliqi- ne së pari nuk e dimë se këto dy familje a janë skamnore apo nuk janë? Gjithashtu nuk janë vetëm këto dy raste, por ka edhe shumë raste të tjera të cilat me të vërtetë duhet analizuar mirë. Mirëpo ne si qytetarë të Komunës së Gjilanit këto dy familje nuk duhet t' i lëmë anash në asnjë mënyrë. Atëherë kur është interesi vital për komunën, atëherë duhet t' i marrim edhe vendimet, mirëpo duhet të kemi kujdes që këto familje t' i sistemojmë përderisa të bëhet zgjidhja. Ne si grup në parim e mbështesim.

Arben Mehmeti- unë jam kundër të gjithë atyre që e trajtojnë KK-në si institucion social dhe human. Po shihet se ka edhe elemente të tilla, por nuk është ashtu, sepse ne si të zgjedhur në këtë Kuvend e kemi obligim dhe e kemi dhënë betimin se do ta zbatojmë ligjin, do të punojmë në harmoni me ligjin etj. Nuk është e drejtë e jona t' i transmetojmë diku tjetër çështjet të cilat ne vetë mund t' i dimë. KK është organi më lartë i kësaj Komune dhe përderisa është organi më i lartë ka edhe përgjegjësi më të larta t' i diskutojë në mënyrë shumë serioze çështjet.

Qemajl Mustafa- së pari Arbeni duhet ta dijë se nuk cenohet plani rregullues i cili është aprovuar para disa kohësh. Ajo zonë ai shirit prej disa ari tokë mbetet për trajtim social. Këtyre familjeve po i ndahet trolli për interes publik për ta liruar sheshin pranë Xhamisë së Metresës, për t' i dhënë mundësi familjeve për ta rivalizuar pronën e vetë. Ajo familje është bërë pengesë edhe për zhvillim të atij sheshi, për realizim të drejtave të lagjes, familjeve tjera të cilave ajo familje u ka dalë në rrugë. Është interes publik 1 minutë e më parë atë familje ta largojmë prej atij vendi, por duke ia zgjidhur çështjen dhe jo duke e hedhur në rrugë! Familja tjetër është brenda objekteve të "Don Boskos" dhe është obligim i imi dhe i Don Boskos që t' ia gjejmë zgjidhjen dhe atë familje ta zhvendosim prej aty.

Arianit Sllamniku- mua më bëri përshtypje reagimi i zv/kryesuesit për çështjen e librit "Anamorava" ku i njëjti person për "Don Boskon" ka votuar për marrje të tokës së xhematit të tij dhe dhënies kishës? Po na shitet këtu dhe moral edhe fetar dhe nacional pa nevojë në fund të mandatit. Nuk kemi çka bisedojmë më tepër në çështje zotëria ka votuar kundër interesit qytetarë edhe për kishën, një hoxhë, një imam.

Te prona e këtij Selim Ramadanit i kam disa dokumente të tij këtu dhe shihet se ka pasur një korrespondencë edhe me AKP-në, por unë sa kam bërë analiza dhe sa kam parë në të gjitha këto dokumente barra i bie Zyrës Ligjore të Komunës së Gjilanit.

Kur është bërë këmbimi i pronës AKP- Komunë, kjo ngastër nuk është paraqitur askund dhe ka mbetur nën hije, sepse tash po na del si rast. Tash ne po duhet ta

trajtojmë. Pse kur është bërë shkëmbimi i pronës në mes Komunës dhe AKP-së nuk ka dal edhe kjo pronë si kontest i cili duhet të zgjidhet më vonë, por ne tash duhet të përballemi në seancë të jashtëzakonshme. Çështja tjetër është azhuriteti dhe unë i kam edhe disa aktvendime të vitit 2006, 2007, 2008 dhe 2009 dhe të gjitha janë në rregull për kompensimin e pronës. Edhe kryetari si e sqaroi kompensimi prej nga vjen për atë ndërtim të ri që do t'i bëhet këtij Selim Ramadanit. Nëse qëndron kjo atëherë të gjithë jemi në rregull, por nëse jo atëherë po shkojmë në një proces vicioz dhe virtuozy i cili nuk na qet askund. Zyra Ligjore së pari duhet ta sqarojë një gjë se institucioni më lartë gjykata, sidomos dhoma e veçantë ku është kjo lëndë para se të merr ajo vendim ne nuk mund të procedojmë në Kuvend. Këtu thuhet në një nen me mirëkuptim me pronarin me marrëveshje me pronarin kjo mund të zgjidhet. Nëse e kemi një marrëveshje dhe nëse qëndron kjo çështja e ndërtimit, atëherë jemi në rregull.

Izmi Zeka- ne po humbim kohë për një çështje e cila është shumë e qartë, por po them diçka që ka harruar LDK-ja, sepse në kohën e LDK-së në atë pjesën e gjelbër është tentuar për të gjet rrugë për këtë qytetarin (Ismet) për ta bërë një zgjidhje, por për shkak të kontestit i cili ka ekzistuar, dokumentacionin që e ka pasur ishte problematike për ta larguar, sepse ai aty kishte banuar me 20-30 vite dhe nuk kemi pasur mundësi për të gjet zgjidhje. Kjo zgjidhje është gjetur sot, vendi atje ku është nuk është pronë e tij është e Komunës dhe ai nuk do ta merr si pronë private personale dhe në momentin e caktuar kur ai bën zgjidhje ia lëshon Komunës.

Nëse bëjmë shkelje të ligjit tash e dini MPL-ja e kthen dhe e sqaron se nuk kemi vepruar sipas ligjit.

Kush është për këtë propozim –vendim?

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrës kadastrale nr.70403013-000162-2 te vendi i quajtur “Porodin” ZK-Gjilan, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, 12 ishin kundër, kurse 3 abstenime.

Me aprovim të këtyre dy vendimeve, seanca e jashtëzakonshme i përfundoi punimet, kurse kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i uron pushim të këndshëm të gjithë anëtarëve të Kuvendit, drejtorëve dhe të tjerëve, por edhe fillim të mbarë të punës në muajin shtator.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA